




# SHTËPI E MADHE



## QEVERISJA E POPULLIT

ELMAR (13), ERJON (13), ENIS (12), LEOTRIM (12), ENES (12), EDINA (12), ALKETA (12), AMARA (12)



### Grupi ynë, me shumë kënaqësi lu fton të mësoni sa më shumë informata rreth demokracisë, përmes artikullit tonë

Ekziston një botë që të gjithë e duan. Në këtë botë, të gjithë njerëzit kanë të drejta. Këto të drejta i gëzojnë të gjithë qytetarët e asaj bote, pa asnjë dallim. Të jetosh




në këtë botë, nënkupton të jetosh në lumturi, në paqe, në tolerancë dhe liri. Eh, sa botë e bukur është kjo! Kush nuk do të dëshironte të ishte pjesë e saj? Këtë botë e quajmë me një emër që ka kuptim të madh, demokraci. A e dini se çfarë do të thotë ky emër? Demokraci do të thotë udhëheqje e popullit. Kjo sepse jemi ne qytetarët ata të cilët udhëheqim në demokraci. Këtë e bëjmë me anë të votës sonë të lirë. E ku ka më mirë se ti të jesh personi i cili zgjedh udhëheqësit e vendit tënd, të cilët njëkohësisht janë edhe për-

faqësuesit e tu? Disa nga elementet e demokracisë janë pikërisht ato që i përmendem më lart. E për ta kuptuar këtë më mirë, ja një shembull. Në klasën tonë është një nxënës me nevoja të veçanta. Për këtë shkak, ai kishte vështirësi të vijonte mësimin, pasi klasa jonë ndodhej në katin e dytë. Ne jemi solidarizuar me të. Jemi mbledhur, jemi organizuar dhe së bashku kemi arritur të mbledhim materialet e nevojshme. Kështu, kemi siguruar shkallët e veçanta në mënyrë që ai të arrinte deri te klasa. Kjo na ka bërë neve shumë të lumtur. E pikërisht kjo ndjenjë solidariteti, tolerance, lirie, e barazie është demokracia. Demokracia ndodhet brenda nesh, në humanitetin dhe barazinë e respektin që ne e tregojmë me të tjerët. Shumë të dashur lexues, këtu po ndahemi me ju, për të vazhduar në artikullin vijues. Aty grupi ynë do të tregojë se si mund të jemi aktiv në shtetin tonë.



Autorët e artikullit

**Si mund të jesh aktiv në vendin tënd? Artikulli ynë flet pikërisht për aktivizimin e qytetarëve dhe mënyrën se si ata mund të ndikojnë në ndërtimin e demokracisë**



**Qytetarët aktiv nuk mendojnë vetëm për të mirën personale. Ata bashkëpunojnë në përmirësimin e jetës në komunitet. Të gjithë duhet të jemi aktiv për të mirën e vendit tonë**



Gjithmonë është më mirë të jemi aktiv, në çdo pjesë të ditës. Kur zgjohemi në mëngjes është mirë të aktivizohemi dhe të vrapojmë, sepse kështu do të jemi të shëndetshëm. Kur jemi në shkollë është mirë të aktivizohemi në orët mësimore. Ndërkaq, kur jemi në shtëpi është mirë të aktivizohemi dhe t'iu ndihmojmë prindërve. Megjithatë, aktivizimi nuk mbaron me kaq. Ne mund të ndikojmë dhe të bashkohemi për të qenë aktiv në vendin tonë.

Njëherë, klasa jonë është organizuar dhe ka kërkuar


nga prindërit që të na e rregullojnë rrugën e lagjes. Prindërit kanë bërë kërkesë në komunë dhe komuna ka pranuar dhe ka rregulluar rrugën tonë. Që do të thotë se çdo iniciativë e jona për të rregulluar diçka në vendin tonë, është aktivizim. Këtë mund ta bëjmë edhe duke qenë pjesë e organizatave të ndryshme të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut. Ju mos e harroni se ne jemi shtylla kryesore dhe më e fortë e demokracisë. Ne duhet të jemi të bashkuar dhe të mos e harrojmë rolin tonë.



**Bëhu aktiv për shtëpinë tënde, lagjen tënde, qytetin tënd, shtetin tënd dhe planetin tënd**



Të drejtat që ne i gëzojmë në demokraci janë të shumta. Falë këtyre të drejtave, ne jetojmë të lumtur dhe ndihemi të rëndësishëm. Të gjithë deputetët e zgjedhur, të cilët punojnë sot në Kuvend, i kemi votuar dhe i kemi zgjedhur ne qytetarët



Të votosh në demokraci do të thotë të jesh pjesë e vendimmarrjes. Ky vendim ndikon në të ardhmen e vendit tonë, prandaj të gjithë duhet të jemi pjesëmarrës



Gjatë aktiviteteve që i mbajmë në Punëtorinë „Demos-ti“. Shumë të lumtur që e patëm këtë mundësi

# KUVENDI NA PËRFAQËSON NEVE

UVEJS (12), ELMEDIN (12), GENTRIT (13), DRILON (13), LENART (12), MEDINA (13), ANILA (12), ANITA (12)



**Kosova është një vend demokratik dhe ne jemi ardhmëria e këtij vendi. Një institucion me rëndësi të madhe është Kuvendi. Për t'u informuar më shumë iu ftojmë ta lexoni artikullin tonë**

Ne si popull demokratik i kemi të drejtat e barabarta. Të drejtat tona janë të garantuara me ligj. Nëse nuk do të ekzistonin ligjet, atëherë as shteti nuk do të funksiononte siç duhet.

Një institucion shumë i rëndësishëm ku merren vendime për të mirën e popullit dhe miratohen këto ligje është Kuvendi. Ky institucion përbëhet nga 120 deputetë, të cilët janë të zgjedhur nga qytetarët e Kosovës. Prej 120 deputetëve, 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, kurse 20 të tjerë i përkasin komuniteteve jo shumicë: serbë, romë, ashkalinjë, egjiptianë, boshnjakë, turq dhe goranë.

Më lart e kemi cekur rëndësinë e ligjeve dhe vendin se ku miratohen apo nuk miratohen ato. Prandaj, njëri nga funksionet e Kuvendit është funksioni legjislativ. Përveç këtij funksioni, Kuvendi ka edhe dy funksione tjera: funksionin kontrollues (mbikëqyr Qeverisë) dhe funksionin përfaqësues (deputetët janë përfaqësuesit e popullit).

Të gjitha ligjet, të cilat propozohen në Kuvend bazohen në Kushtetutën e vendit, e cila është ligj mbi ligjet. Ligjet janë rregulla, të cilat duhet të zbatohen. Edhe ne në shkollën tonë i kemi disa rregulla, për shembull: të mos vrapojmë, të mos ofendojmë njëri-

tjetrin, të dëgjojmë njëri-tjetrin kur flasim, të respektojmë orarin e caktuar, etj.

Kuvendi ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“ dhe është institucioni më demokratik i vendit. Duke e parë rëndësinë e ligjeve dhe ndikimin e tyre në jetën tonë, grupi ynë ka një mesazh për ju të dashur lexues: t'i respektojmë ligjet dhe të jemi qytetarë të përgjegjshëm. Faleminderit për kohën tuaj!



**Kuvendi, vendi ku miratohen ligjet**



**Qohet kështu, sepse ne zgjedhim deputetët me vota**

# ZGJEDHJET NA MUNDËSOJNË NJË JETË MË TË MIRË

ARBESA (12), SHKELZEN (12), ELIVS (12), RINOR (12), ARTA (12), EMIR (12), AMIR (12), ANISA (12)



**Zgjedhjet janë thelbi i demokracisë apo mekanizmi kryesor me të cilin ajo funksionon. Demokracia në të gjitha format e saj bazohet në sistemin zgjedhor. Përmes tij krijohet struktura qeverisëse e një vendi dhe sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve**

Bashkëmohatarë të dashur, grupi ynë sot diskutoi për zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre, si dhe pse ne si fëmijë duhet të jemi të informuar për to. Zgjedhjet janë thelbi i demokracisë apo mjeti kryesor me të cilin ajo funksionon. Demokracia në të gjitha format e saj bazohet

me anë të votës. Si shembull, kemi zgjedhjet e fundit që u mbajtën në vendin tonë me 22 tetor, të cilat ishin zgjedhje lokale.

Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare votuan për kandidatët për asamble komunale dhe për kryetar komune. Çdo qytetar, pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, statusin politik, gjendjen shëndetësore, etj; e gëzon të drejtën e votës dhe e ka gëzuar gjithmonë. E njëjta vlen edhe për zgjedhjet e tjera, që janë zgjedhjet qendrore. Por, në këto zgjedhje, qytetarët votojnë për kandidatët për deputetë. I tërë ky proces zhvillohet në mënyrën më demokratike.

Artikulli ynë vazhdon në faqen tjetër me informacione më të gjera për zgjedhjet. Andaj ju mos u ndani nga ne që të informoheni sa më shumë.



në zgjedhjet. Me anë të zgjedhjeve, krijohen struktura qeverisëse të një vendi, sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në formimin dhe arrihet kontrolli politik i qeverisjes dhe i pushtetit.

Në Kosovë kemi pluralizëm politik. Falë këtij pluralizmi, ne, qytetarët kemi mundësi të zgjedhim atë që ne mendojmë që do t'i sigurojë shtetit përparim. E kjo gjë ndodh përmes sistemit zgjedhor. Parti dhe kandidatë të ndryshëm kandidojnë për marrjen e pushtetit. Kurse, qytetarët i vlerësojnë ato parti apo ata kandidatë



Grupi „Vota“

**Sistemet demokratike karakterizohen veçanërisht nga konkurrenca politike. Kjo ndryshe njihet si pluralizëm politik. Zgjedhjet e rregullta, të përgjithshme, të fshehta dhe të lira u mundësojnë partive që janë në kandidim të marrin pushtetin në mënyrën më demokratike**

Përmes medias, ne u informuam se në zgjedhjet e fundit komunale shumë parti politike kanë fituar pothuajse vota të njëjta. Rasti i njëjtë doli të jetë edhe në Komunën tonë, ku dy parti ishin shumë afër me vota me njëra-tjetrën. Ne mendojmë se jo të gjithë qytetarët në Komunën tonë e kanë shfrytëzuar këtë votë, e për këtë në një farë mënyre kemi edhe këtë rezultat. Prandaj, dëshirojmë t'iu tregojmë se sa rëndësi të madhe ka një votë. Kur gratë fituan të drejtën e votës në Kaliforni, ky ndryshim u arrit vetëm me një votë më shumë. Që do të thotë se për një votë, u vendos që edhe gratë të gëzojnë të drejtën e votës. Në shtetin e Francës, qytetarët vendosën që gjuha franceze të jetë gjuhë zyrtare e jo gjuha angleze, vetëm për një votë. Pra, është jashtëzakonisht e rëndësishme që të dalim të gjithë dhe të marrim pjesë në procesin zgjedhor.



Kosova shënoi zgjedhjet lokale në këtë datë



Disa nga kandidatët për Asamble Komunale në Komunën e Mitrovicës

Shumë të dashur bashkëmoshatarë, e ju prindër. Ne sot e kuptuam se sa e rëndësishme është vota dhe sa peshë të madhe ka. E nga ju kërkojmë, të silleni me përgjegjësi dhe të dilni e të shfrytëzoni të drejtën tuaj. Sepse ne në këtë moshë, akoma nuk mund të marrim pjesë në procesin zgjedhor. Kur të arrijmë moshën adekuate, pa dyshim që edhe ne do të jemi aty, bashkë me juve. Ne e duam vendin tonë, ne mendojmë për të e këtë do ta dëshmojmë me pjesëmarrje në qeverisje e më saktësisht duke votuar.

Trajnerja jonë na tha që qytetarët të cilët e shfrytëzojnë të drejtën e votës janë në një farë mënyre pjesëmarrjës në vendimmarrje. Bëhuni edhe ju pjesë e vendimmarrjes. Dilni dhe votoni!



Në demokraci qytetarët kërkojnë llogari për votën e tyre



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Abdullah Shabani“  
Klasa: VII-2  
Vendi: Mitrovicë